



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AKADEMIA E SHKENCAVE E SHQIPËRISË  
ASAMBLEJA

Tiranë, më 15 janar 2018

**Mbledhje e Asamblesë së Akademisë së Shkencave,  
datë 18 janar 2018, ditën e enjte, ora 13.00,  
në sallën "Aleks Buda"**

Në zbatim të Ligjit nr.9655, date 11.12.2006 "Për Akademinë e Shkencave të Republikës së Shqipërisë", neni 9 dhe 10, i ndryshuar dhe të Statutit të ASH, neni 15 dhe 16, mbështetur shkresës nr. prot. 224, datë 10.01.2018 "Për vijimin e ristrukturimit të Akademisë së Shkencave", të Ministres së Arsimit, Sportit dhe Rinisë, drejtuar Kryesisë së ASH, ku kërkohet caktimi i dy përfaqësuesve të ASH në Komisionin e Përbashkët të Mirëbesimit, si dhe propozimit të Kryetarit të Komisionit Ad-Hoc të reformës, ku kërkohet zëvendësimi i dy anëtarëve të dorëhequr të këtij komisioni, Ju propozojmë organizimin e mbledhjes së Asamblesë së Akademisë së Shkencave më datë 18 janar 2018, ditën e enjte, ora 13.00, në Sallën "Aleks Buda".

**Rendi i ditës:**

1. Zgjedhja e dy përfaqësuesve të ASH në Komisionin e përbashkët të Mirëbesimit mes MASR dhe ASH, për ndjekjen dhe monitorimin e procesit të reformit, mbështetur në shkresën e MASR, në zbatim të Vendimit të Asamblesë së ASH nr. 23, datë 22 dhjetor 2017 "Për aprovimin e kalendarit të reformës institucionale në Akademinë e Shkencave", pika 2.1.
2. Zëvendësimin e dy anëtarëve të dorëqehur nga Komisioni ad-hoc i reformës, referuar kërkesë së Kryetarit të Komisionit ad-hoc, në përmbushje të vendimit të Asamblesë së ASH nr.23, datë 22 dhjetor 2017 "Për aprovimin e kalendarit të reformës institucionale në Akademinë e Shkencave", pika 4,
3. Informacion mbi përgjigjen e ardhur nga ALLEA, në mbështetje të procesit të reformës në Akademinë e Shkencave, referuar vendimit nr.23, datë 22 dhjetor 2017 "Për aprovimin e kalendarit të reformës institucionale në Akademinë e Shkencave", pika 4.

Pjesëmarrja në mbledhje është e detyrueshme.

P.s. Kodi i veshjes në mbledhje të jetë formal/zyrtar.

